



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Agjencia e Kosovës për Akreditim**  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 548/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

**V E N D I M**

- I. Akreditohet BPrAL “Kosovo Art Academy” në nivel institucional për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018;
- II. Akreditohet programi i studimit të BPrAL “Kosovo Art Academy” për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018:
  - Fotografi, BA, 180 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
- III. Obligohet BPrAL “Kosovo Art Academy” që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet BPrAL “Kosovo Art Academy” që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**Arsyetimi**

BPrAL “Kosovo Art Academy” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për Akreditim institucional dhe të programit të studimit: Fotografi, BA, 180 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Fotografi	BA	180	Ujkan Hysaj, Artan Balaj, dhe Kastriot Saqipi

AKA ka organizuar vizitën në BPrAL “Kosovo Art Academy” më 02.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Alan Brickwood dhe Bruce Brown.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL “Kosovo Art Academy”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL “Kosovo Art Academy”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë